



Organization for Security and  
Co-operation in Europe  
**OSCE Mission in Kosovo**

## **Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË**

### **Vlerësim i sigurimit të banimit social nga Komunitat në Kosovë**

**Dhjetor 2013**

*Mohim përgjegjësie:*

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

# PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	3
1. HYRJE .....	4
2. STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE NË KOSOVË .....	5
<b>2.1 Standardet ndërkombëtare</b> .....	5
<b>2.2 Korniza ligjore dhe institucionale në Kosovë</b> .....	6
3. RREGULLORET KOMUNALE DHE MOSPËRPUTHSHMËRIA ME KORNIZËN LIGJORE .....	8
4. MUNGESA E VLERËSIMIT TË NEVOJAVE PËR BANIM DHE STRATEGJIVE PËR BANIM SOCIAL .....	11
5. ZBATIMI I PROJEKTEVE TË BANIMIT SOCIAL .....	13
<b>5.1 Financimi për projektet e banimit social</b> .....	15
<b>5.2 Shpallja publike e projekteve të banimit social</b> .....	15
<b>5.3 Themelimi i komisioneve përzgjedhëse</b> .....	16
<b>5.4 Përzgjedhja e përfituesve</b> .....	19
<b>5.5 Mekanizmi ankimor</b> .....	21
6. PËRFUNDIM .....	22
7. REKOMANDIME .....	24

## **LISTË E SHKURTESAVE**

<b>UA</b>	Udhëzim administrativ
<b>CEDAW</b>	Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër gruas
<b>KDESK</b>	Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore
<b>KDF</b>	Konventa për të drejtat e fëmijës
<b>QMS</b>	Qendra për Mirëqenie Sociale
<b>PNDPC</b>	Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike
<b>PNDESK</b>	Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore
<b>AKP</b>	Agjencia Kosovare e Pronës
<b>MKK</b>	Ministria për Komunitete dhe Kthim
<b>MMPH</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>MAPL</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
<b>MPMS</b>	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
<b>ZKKK</b>	Zyra komunale për komunitete dhe kthim
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë
<b>DUDNJ</b>	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
<b>KB</b>	Kombet e Bashkuara
<b>UNMIK</b>	Misioni i Kombeve të Bashkuar në Kosovë
<b>UNHCR</b>	Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Ky raport vlerëson përparimin e arritur nga komunat e Kosovës drejt realizimit të së drejtës për banim adekuat përmes sigurimit të banimit social dhe i identifikon disa nga mangësitë kryesore në angazhimet e tyre. Raporti bazohet në monitorimin e bërë në terren të sigurimit të banimit social nga komunat në Kosovë të kryer nga OSBE-ja nga nëntori 2010 deri në gusht 2013, si dhe në informacionet e siguruar nga zyrtarët komunalë dhe përfaqësuesit e komunitetit të intervistuar anëmbanë Kosovës gjatë kësaj periudhe kohore.

E drejta për banim adekuat nënkupton që të gjithë personat gëzojnë të drejtën për të banuar ndokund në “siguri, paqe dhe me dinjitet ... pavarësisht nga të ardhurat ose qasja në resurse ekonomike”.<sup>1</sup> Sigurimi i banimit social për persona, të cilët nuk mund ta përballojnë me mjetet e tyre sigurimin e banimit adekuat, është mënyrë e rëndësishme përmes së cilës institucionet qeveritare mund t’i përmbushin obligimet e tyre nga kjo e drejtë.

Deri më sot, institucionet qeveritare në Kosovë kanë ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm në drejtim të realizimit të së drejtës për banim adekuat, duke përfshirë krijimin e kornizës ligjore përkatëse dhe zbatimin e disa projekteve të banimit social në nivel komunal. Megjithatë, janë identifikuar disa brenga të dukshme si mungesa e përputhshmërisë së rregulloreve komunale me kornizën ligjore në Kosovë dhe fakti që disa komuna vazhdojnë të operojnë bazuar në udhëzime të vjetruara për banim social. Gjithashtu, ka pasur mungesë të përparimit në mbarë Kosovën përkitazi me detyrat e komunave dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë (MMPH) për të bërë vlerësim të nevojave për banim dhe për të hartuar strategji të banimit që janë jetike për matjen dhe monitorimin e realizimit të së drejtës për banim adekuat.

Është për t’u lëvdur që disa komuna zbatojnë projekte të banimit social. Megjithatë, janë identifikuar disa brenga procedurale si mungesa e njoftimeve publike për projektet e banimit ose mosrespektimi i kërkesave për përdorim të gjuhëve për njoftime publike që mund t’i lë personat ose komunitetet të painformuar për mundësitë për të aplikuar për banim. Gjithashtu, është e dukshme se shumë prej komisioneve përzgjedhëse komunale dominohen nga anëtarë të kuvendeve komunale, dhe nuk përfshijnë përfaqësuesit e komuniteteve në komunat me minoritete numerike, , dhe/ose përfshijnë përfaqësues nga Shoqata e Veteranëve të Luftës, përderisa përfaqësuesit e grupeve të komuniteteve të cenueshme për të cilët Ligji parasheh që të kenë prioritet për banim social . Përbërja e tillë mund t’i favorizojë disa , në vend se t’u jepet përparësi kategorive të tjera të personave të parapara me ligj, siç janë personat me aftësi të kufizuar dhe persona të tjerë në pozita të cenueshme. Veç kësaj, komisionet përzgjedhëse rrallëherë përfshijnë në përbërje të tyre punonjës komunalë me përvojë në çështje të mirëqenies sociale (siç janë

---

<sup>1</sup> Shih paragrafin 7, Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore (KDESK), Komenti i përgjithshëm nr. 4 (Neni 11(1)): E drejta për banim adekuat, UN Doc. E/1992/23, 13 dhjetor 1991 [http://www.unhchr.ch/tbs/doc.nsf/\(Symbol\)/469f4d91a9378221c12563ed0053547e](http://www.unhchr.ch/tbs/doc.nsf/(Symbol)/469f4d91a9378221c12563ed0053547e) (qasur më 21 tetor, 2013).

drejtoritë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale ose drejtorët e qendrave për mirëqenie sociale). Për më tepër, ka mungesë të të dhënave gjithëpërfshirëse dhe të zbërthyera në kategori për aplikacionet për dhe përfituesit e projekteve të banimit social, gjë që është e nevojshme për ta monitoruar si duhet procedurën e përzgjedhjes. Në fund, ka mungesë të përgjithshme të respektimit të procedurave të rregullta ankimore.

Për ta përmirësuar procesin e sigurimit të banimit social, duhet të ndërmerren disa masa nga institucionet gjegjëse. Komunitat duhet t'i ndryshojnë pa vonesë nenet mospërputhëse të rregulloreve komunale dhe të angazhohen në proces të shqyrtimit të ligjshmërisë së rregulloreve. Veç kësaj, MMPH dhe komunitat duhet t'i shtojnë përpjekjet e tyre për ta monitoruar dhe adresuar çështjen duke kryer vlerësime të nevojave për banim dhe duke hartuar strategji komunale për mbarë Kosovën. Gjithashtu, komunitat duhet t'i reformojnë komisionet përzgjedhëse për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të përfaqësuesve të komunitetit joshqiptar dhe punonjësve relevantë komunalë të trajnuar për t'u marrë me çështje të mirëqenies sociale. Përfundimisht, është jetike që procedura ankimore e paraparë ligjërisht të respektohet në mënyrë që të sigurohet drejtësi në procesin e përzgjedhjes dhe të sigurohet e drejta e aplikuesve për mjet efektiv juridik.

## 1. HYRJE

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj) siguron që të gjithë njerëzit kanë të drejtë në standard jetese që është i përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre, duke përfshirë banim adekuat dhe mbrojtje sociale. Ky standard i të drejtave të njeriut i njohur botërisht, gjithashtu, përfshihet në instrumente të shumta ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Komisioni i Kombeve të Bashkuara (KB) për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (KDESK) vë theks që e drejta e njeriut për banim adekuat është e një rëndësie kritike për gëzim të të gjitha të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.

Në Kosovë, ku afërsisht 34.5 për qind e popullatës jeton në varfëri, derisa afërsisht 12.5 për qind janë në varfëri të skajshme, çështja e sigurimit të banimit social mbetet e rëndësishme më të lartë.<sup>2</sup> Në të vetmin vlerësim për nevoja banesore të kryer nga institucionet në Kosovë deri më sot, komuna e Pejës/Peć ka identifikuar 1,200 familje që ballafaqohen me vështirësi për qasje në banim adekuat, nga të cilat 300 jetonin në varfëri të skajshme dhe kishin nevojë të menjëhershme për strehim social. Megjithatë, ka një mungesë të përgjithshme të informacionit përkitazi me numrin total të personave në nevojë për banim social në Kosovë.

Si pjesë e mandatit të saj për të monitoruar, promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka monitoruar dhe vlerësuar përparimin e arritur dhe mangësitë e institucioneve në Kosovë në vlerësimin e nevojave për banim dhe sigurimin e banimit social për ata që kanë nevojë. Sigurimi i banimit social

---

<sup>2</sup> Varfëria e konsumit në Republikën e Kosovës në vitin 2010, Agjencia e Statistikave, Banka Botërore, dhjetor 2012.

është një masë konkrete që mund të jetë e domosdoshme për ta realizuar të drejtën për banim adekuat dhe standardin adekuat të jetesës për të gjithë njerëzit në Kosovë.

Ky raport vlerëson përparimin e arritur nga komunat në Kosovë drejt realizimit të së drejtës për banim adekuat përmes sigurimit të banimit social dhe identifikon disa nga mangësitë kryesore në angazhimet e tyre.<sup>3</sup> Ai bazohet në monitorimin në terren të sigurimit të banimit social nga komunat e Kosovës që është kryer nga OSBE-ja nga nëntori 2010 deri në muajin gusht 2013, si dhe informacionet e siguruar nga zyrtarët komunalë dhe përfaqësuesit e komuniteteve të intervistuar anembanë Kosovës gjatë periudhës së cekur. Informacione shtesë janë marrë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

Raporti aktual ndahet në shtatë kapituj. Pas hyrjes, kapitulli 2 i përvijon standardet relevante ndërkombëtare dhe kornizën përkatëse ligjore dhe institucionale të Kosovës. Kapitulli 3 vlerëson kornizën ligjore komunale dhe analizon përputhshmërinë (apo mungesën e saj) e rregulloreve komunale për banim social me kornizën ligjore në Kosovë. Kapitulli 4, më pas, e shqyrton përparimin e arritur në drejtim të përmbushjes së obligimeve për të kryer vlerësime të nevojave për banim dhe hartim të strategjive. Kapitulli 5 i shqyrton çështjet procedurale lidhur me zbatimin e projekteve të banimit social në komuna. Në fund, raporti paraqet disa përfundime (Kapitulli 6) dhe rekomandime se si të realizohet më mirë e drejta për banim adekuat përmes projekteve të banimit social, pa diskriminim mbi bazën e asaj që është e ndaluar (Kapitulli 7).

## **2. STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE NË KOSOVË**

### ***2.1 Standardet ndërkombëtare***

Sigurimi i banimit social nga institucionet e Kosovës është masë jetike për realizimin e së drejtës për banim adekuat. Duke e thelluar më tej obligimin e përcaktuar nga DUDNj, Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (PNDESK)<sup>4</sup> përcakton që e drejta për standard adekuat të jetesës dhe banim adekuat duhet të realizohet në mënyrë progresive, duke e shfrytëzuar maksimumin e burimeve në dispozicion.<sup>5</sup> Ndonëse këto të drejta i nënshtrohen realizimit progresiv – duke e pranuar që banimi adekuat nuk mund gjithmonë të sigurohet në mënyrë të menjëhershme për të gjithë personat në nevojë – KDESK thekson se janë disa aspekte të këtyre të drejtave që duhet të zbatohen menjëherë.

Para së gjithash, institucionet në Kosovë duhet të fillojnë menjëherë të “ndërmarrin hapa” drejt realizimit të atyre të drejtave, duke përfshi përmes miratimit të masave legjislative dhe të tjera të nevojshme për ta respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtën për banim

<sup>3</sup> Tri komunat veriore, Leposavić/Leposaviq, Zvečan/Zveçan dhe Zubin Potok, nuk përfshihen në këtë raport.

<sup>4</sup> Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (PNDESK), Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara 2200A (XXI), 16 dhjetor 1966, hyrë në fuqi më 3 janar 1976.

<sup>5</sup> Shih neni 2, PNDESK, shënim 4, sipër.

adekuat.<sup>6</sup> Për më tepër, institucionet duhet të angazhohen menjëherë për të garantuar të drejtën për banim adekuat në përputhje me parimin e mosdiskriminimit të pranuar e njohur botërisht, i cili ndalon diskriminimin në çfarëdo forme që e vë në pyetje gëzimin e barabartë të të drejtave të njeriut. Në mënyrë specifike, e drejta për banim adekuat duhet të respektohet, mbrohet dhe përmbushet pa diskriminim në baza të ndaluara si raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, mendimi politik ose tjetër, origjina kombëtare ose sociale, prona, lindja,<sup>7</sup> aftësia e kufizuar, mosha, statusi martesor ose familjarë, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendja shëndetësore, vendbanimi dhe situata ekonomike apo sociale.<sup>8</sup>

Këto obligime të menjëhershme të mosdiskriminimit dhe të “ndërmarrjes së hapave” drejt realizimit të së drejtës për banim adekuat kanë disa komponentë praktik. Së pari, institucionet duhet ta monitorojnë situatën lidhur me banimin joadekuat dhe të marrin në konsideratë dhe t’i japin përparësi grupeve sociale në gjendje të pafavorshme në sigurim të banimit adekuat. Së dyti, institucionet duhet t’i shfrytëzojnë të dhënat e zberthyera në kategori për të konstatuar shkallën e plotë të banimit joadekuat dhe t’i identifikojnë ato grupe sociale që janë veçanërisht të cenueshme ose në pozitë të pafavorshme.<sup>9</sup> Së treti, institucionet duhet të miratojnë, në konsultim me personat e prekur, një strategji banesore mbarë Kosovare që i identifikon objektivat, burimet në dispozicion, përgjegjësitë dhe afatet kohore për zbatim. KDESK ka elaboruar që, përmes këtyre angazhimeve të vazhdueshme, “obligim është të demonstrohet që, kur të mblidhen, masat që ndërmerren janë të mjaftueshme për ta realizuar të drejtën për çdo individ në kohën më të shkurtë të mundshme në përputhje me maksimumin e burimeve në dispozicion.”<sup>10</sup>

## 2.2 Korniza ligjore dhe institucionale në Kosovë

Korniza ligjore në Kosovë i riafirmon obligimet e institucioneve të qeverisë për të realizuar të drejtën për banim adekuat.<sup>11</sup> Si hap i rëndësishëm në drejtim të realizimit të

<sup>6</sup> Shih paragrafët 1–3, Koment i Përgjithshëm KDESK Nr. 3: Natyra e obligimeve të shteteve palë, UN Doc. E/1991/23, 14 dhjetor 1990 <http://www.unhchr.ch/tbs/doc.nsf/0/94bdbaf59b43a424c12563ed0052b664> (qasur më 21 tetor 2013).

Lidhur me atë se çfarë nënkuptohet me banim adekuat, KDESK ka theksuar që në këtë përfshihet: përbalueshmëria; banueshmëria; qasshmëria; vendndodhja; siguria ligjore e së drejtës banesore; dhe disponueshmëria e shërbimeve, materialeve, hapësirave dhe infrastrukturës; dhe përshtatshmëria kulturore.

<sup>7</sup> Shih neni 2, PNDESK, shënim 4, *sipër*. Ky parim gjithashtu njihet në konventa të tjera që përcaktojnë të drejtën për banim adekuat, siç u përmend në shënimin 4, *sipër*. Shih gjithashtu neni 2 i DUDNJ, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 217 A (III), 10 dhjetor 1948, neni 2 i Konventës për të drejtat e fëmijës (KDF), Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 44/25, 20 nëntor 1989, neni 1 i CEDAW, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 34/180, 18 dhjetor 1979.

<sup>8</sup> Shih KDESK, Koment i Përgjithshëm Nr. 20: Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (neni 2 paragrafi 2), 10 qershor 2009, UN Doc. E/C.12/GC/20, paragrafët 27–35.

<sup>9</sup> Shih paragrafët 11–14, KDESK Koment i Përgjithshëm Nr. 4, shënim 1, *sipër*.

<sup>10</sup> Shih paragrafi 14, *po aty*.

<sup>11</sup> Të drejtat e përmbajtura në DUDNJ, CEDAW dhe KDF, duke përfshirë të drejtën për banim adekuat janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë me nenin 22 të Kushtetutës. Për më tepër, në pajtim me nenin 1.3 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut Nr. 1999/24 për Ligjin e zbatueshëm në Kosovë, 12 dhjetor 1999, personat që ushtrojnë detyra publike apo mbajnë pozita publike obligohen t’i respektojnë dispozitat e PNDESK, DUDNJ, CEDAW dhe KDF.

këtyre obligimeve, Ligji për financimin e projekteve të veçanta të banimit (në tekstin e mëtutjeshëm ‘Ligji për banim’) u miratua në vitin 2010 me qëllim të sigurimit të qasjes në banim adekuat për ata që nuk mund t’ia lejojnë vetës apo përballojnë një të tillë.<sup>12</sup>

Korniza ligjore përcakton vendosmërisht se sigurimi i banimit social është përgjegjësi e nivelit komunal<sup>13</sup>, ndërsa MMPH është organi përgjegjës për mbikëqyrjen e Ligjit për banim<sup>14</sup>. MMPH-ja më pas e ka plotësuar Ligjin për banim me gjashtë udhëzime administrative (UA)<sup>15</sup>, i fundit nga të cilët u miratua në nëntor 2010.

Për më tepër, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) gjithashtu sigurojnë financim për projekte banimi në përputhje me ligjin. Pas kompletimit të kornizës ligjore, MMPH, me mbështetjen e OSBE-së, ka mbajtur disa punëtori në 2011 dhe 2012 për ta prezantuar këtë kornizë ligjore para komunave dhe për t’i diskutuar obligimet që i kanë sipas saj.<sup>16</sup>

Parimet e të drejtave të njeriut të njohura botërisht të barazisë dhe mosdiskriminimit gjithashtu reflektohen në kornizën ligjore në Kosovë, e cila siguron që të drejtat e të gjithë personave do të njihen pa dallim dhe që të gjithë personat kanë qasje të barabartë në shërbime të nivelit lokal.<sup>17</sup> Duke qenë kështu, komunat obligohen të sigurojnë banim social në baza të barabarta dhe të drejtuara nga nevoja.

---

<sup>12</sup> Neni 1, Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, 27 mars 2010 (Ligji për banim) thotë që qëllimi i këtij ligji është të “Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kushteve për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t’i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave si dhe caktimi i mënyrës së sigurimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e programeve të veçanta të banimit [sic]”.

<sup>13</sup> Shih neni 17.1 i Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, 15 qershor 2008. Shih gjithashtu neni 4, Ligji për banim, shënim 12, sipër.

<sup>14</sup> Shih neni 27, po aty.

<sup>15</sup> UA Nr. 18/2010 për Përmbytjen e kontratës për banesat me qira joprofitabile, 2 shtator 2010; UA Nr. 19/2010 Përmbytjen e bonusit të banimit, 02 shtator 2010; UA Nr. 21/2010 për “Kriteret e përcaktimit të radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë, 18 dhjetor 2010; UA Nr. 22/2010 Procedurat për përfitimin nga programet e veçanta të banimit, 18 nëntor 2010; UA Nr. 23/2010 për Procedurat për shpalljen e programeve të veçanta të banimit, 18 nëntor 2010; UA Nr. 24/2010 për Normat minimale të banimit për banesat e programeve të veçanta të banimit, 18 nëntor 2010.

<sup>16</sup> Punëtoritë u mbajtën me 13, 14, 20, 21 dhe 28 tetor 2011 dhe në ato morën pjesë rreth 150 zyrtarë të përzgjedhur komunalë. Para punëtorive, OSBE-ja shtypi dhe shpërndau ligjin e ri dhe udhëzimet administrative, si dhe fletushka sqaruese e afishe. Në 2012, punëtoritë u mbajtën më 15, 16, 22, 23, dhe 24 tetor dhe pritën afërisht 120 pjesëmarrës. Ligjëruesit ekspertë u siguruan nga departamentet relevante të MMPH. OSBE do ta përkrahë MMPH-në më tej me aktivitete pasuese nga fundi i 2013 për të diskutuar rreth përparimit të arritur dhe pengesat me të cilat janë ballafaquar komunat.

<sup>17</sup> Shih neni 4.2, Ligji për vetëqeverisje lokale, shënim 13, sipër. Shih gjithashtu neni 3.4 i Ligjit Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, 18 mars 2008.



### 3. RREGULLORET KOMUNALE DHE MOSPËRPUTHSHMËRIA ME KORNIZËN LIGJORE

Në mars 2010, Ligji për banim hyri në fuqi dhe në nëntor 2012 MMPH nxori UA-në e fundit nga gjashtë sosh<sup>18</sup> për zbatimin e Ligjit për banim. Ligji për banim, së bashku me këto gjashtë akte nënligjore ua mundëson komunave të zbatojnë projekte të banimit social dhe t'i përzgjedhin përfituesit nga këto projekte. Fatkeqësisht, deri më sot vetëm pesë komuna kanë zbatuar projekte të tilla. Veç kësaj, këto pesë komuna e kanë bërë këtë në mënyrë të tillë që duket të jetë në kundërshtim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me kornizën ligjore.

Që nga qershori 2013, pesë komuna kanë miratuar rregullore komunale për banimin social: Peja/Peç<sup>19</sup>, Lipjani/Lipljane<sup>20</sup>, dy në Prishtinë/Priština<sup>21</sup>, Ferizaj/Uroševac<sup>22</sup>, Kamenicë/Kamenica<sup>23</sup>. Disa komuna të tjera e kanë theksuar nevojën për rregullore të tillë dhe për zbatimin e tyre në një të ardhme të afërt.<sup>24</sup> Pesë komuna (Klinë/Klina<sup>25</sup>, Gjakovë/Đakovica<sup>26</sup>, Glllogoc/Glogovac<sup>27</sup>, Skenderaj/Srbica<sup>28</sup> dhe Mitrovicë/Mitrovica<sup>29</sup>) nuk kanë rregullore por kanë operuar bazuar në udhëzimet e MMPH për banim social nga viti 2007<sup>30</sup>. Këto udhëzime janë qartazi të vjetruara, meqë janë publikuar tre vite para Ligjit për banim dhe, rrjedhimisht, parashohin kritere të ndryshme të përzgjedhjes nga ato të parapara në Ligjin për banim dhe UA, si dhe përbërje të ndryshme për komisionet përzgjedhëse.

---

<sup>18</sup> Shih shënim15, sipër.

<sup>19</sup> Rregullore Komunale Nr.022/4429 për dhënie me qira të banesave në pronësi komunale për raste sociale, 10 qershor 2010.

<sup>20</sup> Rregullore Komunale Nr.360/2890 për përcaktimin e kritereve për dhënie me qira të banesave në pronësi komunale, 31 maj 2011.

<sup>21</sup> Komuna e Prishtinës/Priština ka dy rregullore për banim social: Rregullorja Komunale 01 Nr. 360/1938 për dhënien e banesave të komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira për rastet me përkujdesje sociale, 28 korrik 2010; Rregullore Komunale 01 Nr. 360/2803 për dhënien e banesave të komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së, 29 shtator 2011.

<sup>22</sup> Komuna Ferizaj/Uroševac Rregullorja Nr. 01/87 në përcaktimin e kushteve dhe kritereve për dhënien me qira të banesave në pronësi komunale, dhjetor 2012.

<sup>23</sup> Rregullore Komunale Nr. 02/4626 për dhënien me qira të banesave në pronësi komunale për raste sociale, 30 prill 2013.

<sup>24</sup> Gjilan/Gnjilane, Štrpce/Shtërpçë dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje.

<sup>25</sup> Drejtor, drejtorja e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, Komuna Klinë/Klina, Klinë/Klina, intervistë verbale, 4 qershor 2012.

<sup>26</sup> Drejtor, drejtorja e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, Gjakovë/Đakovica, Komuna Gjakovë/Đakovica, intervistë verbale, 6 qershor 2012.

<sup>27</sup> Drejtor, drejtorja e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, Komuna Glllogoc/Glogovac, Glllogoc/Glogovac, intervista verbale, 1 qershor 2012 dhe 20 maj 2013.

<sup>28</sup> Drejtor, drejtorja e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, Komuna Skenderaj/Srbica, Skenderaj/Srbica, intervistë verbale, 10 qershor 2012 dhe 30 maj 2013.

<sup>29</sup> Drejtor dhe zyrtar, drejtorja për integritet evropian dhe mirëqenie sociale, Komuna Mitrovicë/Mitrovica, Mitrovicë/Mitrovica, intervistë verbale, 08 qershor 2012 dhe 24 maj 2013.

<sup>30</sup> Udhëzimet për Banim Social, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, 2007. Vëreni që udhëzimet e vjetruara nuk janë më dispozicion në ueb-faqen e MMPH-së.

Rregulloret komunale të miratuara nga pesë komunat e para të sipërpërmendura përmbajnë disa dispozita që nuk janë plotësisht në përputhje me Ligjin dhe UA-të gjegjëse. Një fushë e rëndomtë e mospërputhjes është ajo e kritereve për përzgjedhjen e përfituesve të banimit social. Korniza ligjore përcakton një sistem pikësh përmes së cilit pikët u jepen përfituesve potencialë në disa kategori: statusin banesor; të ardhurat; gjendjen shëndetësore; aftësinë e kufizuar; strukturën e familjes; si dhe kritere shtesë (familjarë të martirëve; familje me një prind; familje që kujdesen për jetimë).<sup>31</sup> Megjithatë, sistemi i pikëve i rregulloreve komunale të Pejës/Peć, Prishtinës/Priština, Ferizajt/Uroševac, Kamenicës/Kamenica dhe Lipjanit/Lipljane dallon në mënyrë të konsiderueshme. Secila prej tyre ka kategori të ndryshme dhe sisteme të ndryshme të pikëve krahasuar me Ligjin.<sup>32</sup> Sidomos, Lipjani/Lipljane dhe Ferizaji/Uroševac japin gjithashtu pikë më të larta për pjesëmarrje në luftë se sa ato të parapara në Ligj.<sup>33</sup> Në rastin e Prishtinës/Priština, ka dy rregullore që i synojnë dy kategori të ndryshme përfituesish, që hap potencialisht dyert për diskriminim, nepotizëm dhe/ose korrupsion dhe e shkel sistemin e pikëve të përcaktuar nga Ligji për banim.

Një fushë tjetër e mospërputhjes është përbërja e paraparë e komisioneve përzgjedhëse komunale, organit përgjegjës për përzgjedhjen e përfituesve. Korniza ligjore nuk flet rreth përbërjes specifike të komisioneve përzgjedhëse, por përcakton se kryetari i komunës i cakton tre deri në pesë anëtarë në këto komisione.<sup>34</sup> Megjithatë, rregullorja komunale e Pejës/Peć përcakton përbërje të komisionit prej nëntë anëtarëve, rregullorja komunale e Ferizajt/Uroševac përcakton përbërje të komisionit përzgjedhës prej 11 anëtarëve, rregullorja komunale e Kamenicës/Kamenica parasheh komision përzgjedhës prej pesë anëtarëve dhe rregullorja komunale e Lipjanit/Lipljane përcakton që komisioni komunal do të përbëhet prej shtatë anëtarëve<sup>35</sup>. Komisionet përzgjedhëse të Ferizajt/Uroševac, Kamenicës/Kamenica, Pejës/Peć dhe Lipjanit/Lipljane krijohen nga kuvendi komunal, në vend se këtë ta bëjë kryetari i komunës, ashtu siç kërkohet me Ligji për banim<sup>36</sup>. Kryetari i komunës së Prishtinës/Priština ka themeluar dy komisione përzgjedhëse, që të dyja të përbëra nga pesë anëtarë, për kategori të ndryshme të përfituesve. Njëri prej komisioneve përzgjedhëse ka detyrë të merret me sigurimin e banimit për veteranët e luftës, ndërsa tjetri merret me çështjet e banimit e të gjitha grupeve të tjera të cenueshme.<sup>37</sup>

Përfundimisht, procedura e ankimit e siguruar në rregulloret komunale është jokonsistente me atë që e përcakton Ligji për banim dhe me të cilën parashihet që palët e

---

<sup>31</sup> Shih neni 5, Ligji për banim, shënim 12, *sipër*. Shih gjithashtu nenet 5 - 10 dhe shtojcën 1 të UA-së 21/2010, shënim 15, *sipër*.

<sup>32</sup> Shih nenin 12, rregullorja komunale e Pejës/Peć, shënim 19, *sipër*. Neni 9 i rregullores komunale të Prishtinës/Priština 01, shënim 21, *sipër*. Shih neni 6 i rregullores komunale të Lipjanit/Lipljane, shënim 20, *sipër*. Shih gjithashtu neni 9 i rregullores komunale të Ferizajt/Uroševac, shënim 22, *sipër*.

<sup>33</sup> Shih neni 6, rregullorja komunale e Lipjanit/Lipljane, shënim 20, *sipër*.

<sup>34</sup> Shih nenin 5, UA 22/2010, shënim 15, *sipër*.

<sup>35</sup> Shih neni 13, rregullorja komunale e Pejës/Peć, shënim 19, *sipër*. Shih gjithashtu nenin 10, rregullorja komunale e Lipjanit/Lipljane, shënim 20, *sipër*. Shih nenin 10 të rregullores komunale të Kamenicës/Kamenica, shënim 23, *sipër*.

<sup>36</sup> *Po aty*.

<sup>37</sup> Shih nenin 10, Rregullorja komunale e Prishtinës/Priština 01 nr. 360/1938, dhe nenin 10 të Rregullores komunale të Prishtinës/Priština 01 nr. 360/2803, shënim 21, *sipër*.

pakënaqura mund të ankohen kundër vendimeve të komisioneve përzgjedhëse në MMPH.<sup>38</sup> Nga ana tjetër, kundër vendimeve të MMPH mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën Supreme.<sup>39</sup> Në rastin e Pejës/Peć, Prishtinës/Priština (rregullorja që i referohet grupeve të cënueshme përveç veteranëve të luftës), Lipjanit/Lipljane dhe Kamenicës/Kamenica, rregulloret komunale parashohin vetëm që palët e pakënaqura mund t'i ankohen vetë komisionit përzgjedhës e më pas Gjykatës Supreme, por jo në MMPH.<sup>40</sup> Në rastin e Ferizajt/Uroševac, rregullorja komunale parasheh që vendimi i kuvendit komunal nuk mund të jetë subjekt i ankimit, por palët mund të nisnin kontest administrativ në Gjykatën Supreme, jo më vonë se 30 ditë pas datës kur vendimi i komisionit iu dorëzohet palëve.<sup>41</sup> Kjo mund të rezultojë në mohimin e së drejtës të palëve të prekura për mjet efektiv juridik, si dhe të drejtën e tyre për banim adekuat, në shkëlqje të obligimeve ligjore të institucioneve.<sup>42</sup>

Në Kosovë, problem i përgjithshëm vazhdon të jetë mosrespektimi i procesit të rishqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë së rregulloreve komunale. Rregulloret e miratuara nga kuvendet komunale i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë nga “autoriteti mbikëqyrës”.<sup>43</sup> Në praktikë, komuna duhet t’ia përcjellë rregulloren Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), e cila më pas duhet t’ia përcjellë ministrisë së linjës për shqyrtim (në këtë rast, MMPH). Megjithatë, sipas komunës së Pejës/Peć<sup>44</sup>, ata asnjëherë nuk i kanë dorëzuar rregulloret e tyre për shqyrtim. Komuna e Lipjanit/Lipljane theksoi që e kanë dërguar rregulloren e tyre për shqyrtim në korrik 2011 dhe kanë marrë përgjigje në shtator 2012. MMPH gjeti se, në përgjithësi, rregullorja nuk është në përputhje me Ligjin për banim dhe UA-të gjegjëse.<sup>45</sup> Sipas komunës së Ferizajt/Uroševac, rregullorja komunale është dorëzuar për shqyrtim më 11 maj 2013. MAPL u përgjigj më 24 prill<sup>46</sup> duke gjetur se neni 4 që përcakton kohëzgjatjen e marrëveshjes për qira me familjarët e martirëve të luftës me afat të pacaktuar ishte në kundërshtim me nenin 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 04/L-144 për ndarjen për shfrytëzim dhe shkëmbimin e pronës së paluajtshme të komunës<sup>47</sup>. Sipas komunës së Prishtinës/Priština, që të dy rregulloret u dorëzuan dhe miratuan pa komente. Megjithatë, MMPH theksoi që

<sup>38</sup> Shih nenin 14, Ligji për banim, shënim 12, *sipër*.

<sup>39</sup> Shih nenin 14, Ligji për banim, shënim 12, *sipër*. Shih nenin 15 të rregullores komunale të Ferizajt/Uroševac, shënim 22, *sipër*. Shih gjithashtu nenet 5.7 dhe 6.2 të UA-së 22/2010, shënim 15, *sipër*.

<sup>40</sup> Shih nenin 19, rregullorja komunale Pejës/Peć, shënim 19, *sipër*. Shih gjithashtu nenin 15 të rregullores komunale të Prishtinës/Priština 01 Nr. 360/1938 dhe nenin 15 të rregullores komunale të Prishtinës/Priština 01 Nr. 360/ 2803, shënim 21, *sipër*. Shih gjithashtu nenet 14 dhe 15 të rregullores komunale të Lipjanit/Lipljane, shënim 20, *sipër*. Shih nenin 15 të rregullores komunale të Kamenicës/Kamenica, shënim 23, *sipër*.

<sup>41</sup> Shih nenin 20.2 i rregullores komunale të Ferizajt/Uroševac, shënim 22, *sipër*.

<sup>42</sup> Shih nenin 8, DUDNJ. Shih gjithashtu neni 2.3, PNDCP, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 2200A (XXI), 16 dhjetor 1966, hyrë në fuqi më 23 mars 1976.

<sup>43</sup> Shih nenin 81, Ligji për vetëqeverisje lokale, shënim 13, *sipër*.

<sup>44</sup> Drejtor, drejtorja për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, komuna e Pejës/Peć, Pejës/Peć, intervistë verbale, 18 janar 2012.

<sup>45</sup> Zyrtar ligjor komunal, komuna e Lipjanit/Lipljane, Lipjan/Lipljane, intervistë verbale, 26 shtator, 2012.

<sup>46</sup> Letra e MAPL-së nr.0204-303/2, 24 prill 2013.

<sup>47</sup> Shih nenin 5 dhe 6, Nr. 04/L-144 për ndarjen për shfrytëzim dhe shkëmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, 2 janar 2013. Sipas Ligjit për banim, komuna mund të ndajë tokë për përdorim në periudhë afatshkurtër nga një deri në pesëmbëdhjetë vjet, derisa periudha e përdorimit afatgjatë mund të jetë nga pesëmbëdhjetë deri në nëntëdhjetenëntë vjet.

ata kurrë nuk i kanë pranuar rregulloret komunale të Prishtinës/Priština. Prandaj, ka indikacione të qarta që procesi i shqyrtimit nuk respektohet dhe se ka nevojë për bashkërendim dhe bashkëpunim më të mirë ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal në këtë drejtim.

Një vështrim më pozitiv, MMPH dhe MAPL kanë ndërmarrë hapa për përmirësimin e sistemit të shqyrtimit të ligjshmërisë. Në korrik 2012, dy ministratë kanë themeluar një komision të përbashkët për të shqyrtuar ligjshmërinë e rregulloreve komunale. Kjo duhet të ndihmojë në normëzimin e procesit të shqyrtimit dhe për të siguruar bashkërendim ndërmjet ministrive gjegjëse. Sipas MMPH, komisioni i përbashkët tashmë ka filluar me shqyrtimin e rregulloreve të Lipjanit/Lipljane, Ferizajt/Uroševac dhe Kamenicës/Kamenica.<sup>48</sup>

Në përmbledhje, vazhdon të ketë probleme të mospërputhjes së aspekteve të secilës prej këtyre rregulloreve komunale me kornizën ligjore. Fushat e përbashkëta të mospërputhjes lidhen me kriteret për përzgjedhjen e përfituesve, përbërjen e komisioneve komunale për përzgjedhje dhe procedurat e ankimit. Pavarësisht nga këto mospërputhje, asnjë prej komunave nuk e ka ndryshuar rregulloren për të qenë në përputhje me kornizën ligjore. Është tejet e rëndësishme që secila komunë t'i adresojë këto çështje për të siguruar që projektet e banimit social të zbatohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente. Është gjithashtu e rëndësishme që institucionet e nivelit qendror dhe atij lokal të angazhohen si duhet në procesin e detyrueshëm të shqyrtimit për rregulloret komunale për të siguruar ligjshmërinë e tyre.

#### **4. MUNGESA E VLERËSIMIT TË NEVOJAVE PËR BANIM DHE STRATEGJIVE PËR BANIM SOCIAL**

Sipas Ligjit për banim, nga komunat kërkohet të kryejnë vlerësime të nevojave për banim në fushat e tyre përkatëse të përgjegjësisë. Bazuar në këto vlerësime të nevojave për banim, ato më pas duhet të hartojnë strategji trevjeçare të banimit, duke përfshirë elemente siç janë nevojat për banim, nevojat për financim dhe identifikim të tokës në dispozicion për ndërtim të banesave.<sup>49</sup> Ligji për banim, pastaj, kërkon nga MMPH të hartojë një strategji trevjeçare për tërë Kosovën – përfshi këtu edhe ndarjen e buxhetit–bazuar në informacionet e siguruar nga komunat, si dhe të themelojë një bazë të të dhënave për tërë Kosovën lidhur me nevojat për banim.<sup>50</sup>

---

<sup>48</sup> Drejtori i departamentit për banim social, MMPH, korrespondencë me shkrim, 18 qershor 2013, dhe intervistë, 9 korrik 2012. Vëreni që komisioni i përbashkët ka shqyrtuar gjithsej 11 dokumente që nga themelimi i tij. Përveç shqyrtimit të 3 rregulloreve të cekura më lartë, komisioni i përbashkët ka shqyrtuar 8 raporte dhe vendime të dorëzuara nga komunat, p.sh. vendimet e Vitisë/Vitina për ndarjen e banesave për programe të veçanta të banimit dhe thirrje publike për ndarjen e banesave për programet e veçanta të banimit.

<sup>49</sup> Shih nenet 20 dhe 25, Ligji për banim, shënim 12, *sipër*.

<sup>50</sup> Shih nenin 24, *po aty*.

Ligji për banim nuk siguron asnjë hollësi përkitazi me atë se çfarë duhet të përfshihet në vlerësimet për nevojat për banim të nivelit komunal. Megjithatë, udhëzimet për raportim të nxjerra nga PNDESK dhe raporti nga Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejta të Njeriut (ZKLDNJ) për indikatorët për monitorimin e zbatimit të, mes tjerash, të drejtave nga PNDESK (përfshi këtu të drejtën për banim adekuat), ofrojnë udhëzim<sup>51</sup>.

Në mënyrë më specifike, institucionet kompetente të qeverisjes (MMPH dhe komunat në Kosovë) duhet të mbledhin informacione për listat e pritjes për banim social, kohëzgjatjen e pritjes dhe shpenzimet publike për banim social. Për më tepër, të dhënat duhet të kategorizohen për të dhënë mundësi të monitorimit të banimit social meqë ka të bëjë me personat me nevoja speciale. KDESK gjithashtu ka ofruar një listë joshteruese të personave, të cilëve duhet të ju sigurohet një shkallë përparësie në fushën e banimit, duke i përfshirë: “të moshuarit, fëmijët, personat me aftësi të kufizuar, të sëmurët pa shërim, individët HIV- pozitiv, personat me probleme të vazhdueshme mjekësore, të sëmurët mendorë, viktimat e katastrofave natyrore, njerëzit që jetojnë në zona me prirje për katastrofa dhe grupe të tjera”<sup>52</sup>.

Pavarësisht nga këto obligime, të gjitha komunat e vlerësuara, me përjashtim të njëjës, nuk kanë bërë vlerësim të nevojave për banim dhe nuk kanë krijuar strategji për banim social. Deri në gusht të vitit 2013, Peja/Peć ishte komuna e vetme që kishte kryer vlerësim të nevojave për banim. Në vlerësimin e saj, ajo kishte identifikuar 1,200 familje të cilat ballafaqohen me vështirësi për qasje në banim adekuat. Nga këto, komuna vlerësoi se 300 familje jetojnë në gjendje të varfërisë së skajshme dhe kishin nevojë të menjëhershme për banim social<sup>53</sup>. Në mënyrë të dukshme, nuk janë shfrytëzuar kriteret për përfitim të përcaktuara në kornizë ligjore; në vend të kësaj, komuna është mbështetur në rregullore komunale. Të dhënat e mbledhura gjatë vlerësimit nuk janë kategorizuar në mënyrë të tillë për t’ju dhënë përparësi individëve ose familjeve që janë në rrezik më të lartë.

Ndonëse shumë komuna të tjera theksuan se kishin kryer të tilla vlerësime, është e dukshme se ato i referohen vetëm angazhimit të tyre për regjistrimin e kërkesave *ad hoc* të banimit të pranuar nga individë, se sa një vlerësimi proaktiv dhe gjithëpërfshirës të nevojave për banim në tërë komunën.<sup>54</sup> Kjo qasje i përjashton të gjithë ata që nuk aplikojnë për asistencë për banim direkt në komunë për dhe për rrjedhim nuk jep pasqyrë të saktë të nevojave për banim social për komunë. Vlen të theksohet se, sipas MMPH, deri në gusht 2013, asnjë komunë nuk kishte hartuar apo miratuar program banimi

---

<sup>51</sup> Shih paragrafin 8, Koment i përgjithshëm i KDESK nr. 4, shënim 1, *sipër*; shih gjithashtu *Udhëzimet për dokumentet specifike të traktatit që duhet dorëzuar nga shtetet palë sipas nenit 16 dhe 17 të Paktit ndërkombëtarë për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore*, UN Doc. E/C.12/2008/2, 18 nëntor 2008, në paragrafët. 42–43. Shih gjithashtu *Raporti mbi indikatorët për promovimin dhe monitorimin e zbatimit të të drejtave të njeriut*, UN Doc. HRI/MC/2008/3, 6 qershor 2008, f. 29, [http://www2.ohchr.org/english/issues/indicators/docs/HRI.MC.2008.3\\_en.pdf](http://www2.ohchr.org/english/issues/indicators/docs/HRI.MC.2008.3_en.pdf), (qasur më 21 tetor 2013).

<sup>52</sup> Komenti i përgjithshëm i KDESK nr. 4, në paragrafin 8(e), shënim 1, *sipër*.

<sup>53</sup> Vlerësimi i nevojave është kryer në vitin 2009, drejtori, drejtorja për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, komuna Pejë/Peć, Pejë/Peć, intervistë verbale, 12 shkurt 2013.

<sup>54</sup> Për shembull, Gjilani/Gnjilan, Ferizaj/Uroševac, Vitia/Vitina, Glogoci/Glogovac, Podujeva/Podujevo, Skenderaj/Srbica, Mitrovica/Mitrovica, Fushë Kosova/Kosovo Polje, Shtimja/Štimlje, Lipjani/Lipljan, Obilić/Obiliqi, Suhareka/Suva Reka, Malisheva/Mališevo.

trevjeçar<sup>55</sup>. Në vend të kësaj, sapo të ketë fonde në dispozicion, zhvillohen projekte specifike të banimit në baza *ad hoc*.

Një arsye e rëndomtë e cituar përse nuk janë kryer vlerësime të nevojave për banim ose përse nuk janë hartuar plane banimi është mungesa e fondeve komunale për të ndërtuar banim. Një arsyetim i tillë duket se shkon kundër intuitës, meqë është shumë më vështirë për komunat të kërkojnë financim të jashtëm nëse nuk kanë informacione të sakta për nivelin apo shkallën e nevojave të tyre për banim. Disa komuna më të vogla theksuan se nuk i kryejnë këto vlerësime, apo nuk hartojnë plane për banim, meqë konsiderojnë se nuk kanë familje ose persona me nevojë për banim social.<sup>56</sup> Megjithatë, kjo duket të jetë një argument me pak peshë në mungesë të vlerësimit për nevoja të banimit në tërë komunën. Për më tepër, ky pohim është kundërshtuar drejtpërdrejt në disa raste, qoftë nga Zyrat komunale për kthim dhe komunitete (ZKKK) ose nga përfaqësuesit e komunitetit, të cilët i kanë identifikuar komunitetet në nevojë për banim social në komunat e tyre.<sup>57</sup>

Obligimet tjera përfshijnë kërkesa për zhvillim të proceseve, siç është miratimi i një strategjie banimi për tërë Kosovën dhe monitorimi efektiv i shkallës së banimit joadekuat që duhet të përfshijë të dhëna të zërthyera në kategori dhe t'i identifikojë grupet sociale në situatë më të pafavorshme dhe të cenueshme.<sup>58</sup> Megjithatë, mungesa e të dhënave gjithëpërfshirëse dhe të zërthyera në kategori në nivel komunal ua pamundëson institucioneve të nivelit lokal dhe atij qendror të kenë një pasqyrë të qartë dhe të saktë të shkallës së nevojave për banim social në fushën e tyre të përgjegjësisë. Kjo, nga ana tjetër, i parandalon komunat që të reagojnë si duhet ndaj këtyre nevojave dhe të vlerësojnë përparimin e bërë drejt realizimit të së drejtës për banim adekuat. Kjo gjithashtu parandalon MMPH-në që të përmbush obligimet e saj për hartimin e strategjisë trevjeçare dhe themelimin e bazës së të dhënave për tërë Kosovën. Rrjedhimisht, dështimi i institucioneve për t'i matur dhe ndjekur nevojat për banim përbën shkelje të obligimeve që i kanë sa i përket të drejtës për banim adekuat.

## 5. ZBATIMI I PROJEKTEVE TË BANIMIT SOCIAL

Tetë komuna kanë përfunduar një ose më shumë projekte banimi që nga kompletimi i kornizës ligjore në nëntor 2010. Tabela 1 paraqet një listë të projekteve të banimit social të përfunduara për komunë dhe numrin e njësive të banimit për projekt.

Projekte për komunë	Viti	Nr. i njësive
---------------------	------	---------------

<sup>55</sup> Komuna e Lipjanit/Lipljane pohon se ka hartuar një program banimi 2013-2015 dhe ia ka dorëzuar MMPH-së për shqyrtim dhe komentim në maj 2013. Deri më sot, komuna nuk ka marrë asnjë përgjigje nga MMPH. Burimi: Zyrtari ligjor komunal, 28 maj 2013.

<sup>56</sup> Klokot/Kllokoti, Novo Brdo/Novobërda, Ranilug/Ranillugu, Parteš/Parteshi, Kaçaniku/Kaçanik, Hani i Elezit/Elez Han, Dragashi/Dragaš dhe Mamuša/Mamusha/Mamuša (informacione të siguruar nga drejtorët e drejtorive përkatëse komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale).

<sup>57</sup> Klokot/Kllokot, Novo Brdo/Novobërdë, Ranilug/Ranillug dhe Parteš/Partesh.

<sup>58</sup> Neni 24 i Ligjit për banim, shënim 12, sipër. Shih gjithashtu nenet 4, 20 dhe 21, po aty.

		për projekt
Pejë/Peć (1)	2011	25 <sup>59</sup>
Pejë/Peć (2)	2011	6 <sup>60</sup>
Pejë/Peć (3)	2013	18 <sup>61</sup>
Gjakovë/Đakovica	2011	25
Klinë/Klina	2011	25
Gjilan/Gnjilane (1)	2010	9
Gjilan/Gnjilane (2)	2011	27
Ferizaj/Uroševac (1)	2010/11 <sup>62</sup>	13
Ferizaj/Uroševac (2)	2011	4
Suharekë/Suva Reka (1)	2011	4
Prishtinë/Priština (1)	2011	48
Prishtinë/Priština (2)	2012	52
Glllogoc/Glogovac (1)	2010	25
Glllogoc/Glogovac (2)	2011	23

**Tabela 1: Projektet e banimit social të përfunduara nga komunat (periudha nëntor 2010 – qershor 2013)**

Janë zbatuar gjithsej 14 projekte dhe janë ndarë 304 njësi të banimit social. Disa komuna të tjera kanë nisur projekte të banimit social, por ato ende nuk janë përmbyllur për shkak se nuk janë deklaruar listat përfundimtare të përfituesve.<sup>63</sup> Megjithatë, intervistat me zyrtarët komunalë dhe përfaqësuesit e komuniteteve kanë shpalosur se ka ende nevojë të konsiderueshme për më tepër projekte të banimit social.

Komuna e Prishtinës/Priština e ka përfunduar një projekt në pajtim me Rregulloren e parë 01 nr. 360/1938 për dhënien e banesave në shfrytëzim me qira për rastet me përkujdesje sociale. Një tjetër projekt, i përmbyllur në dhjetor të vitit 2012, është kryer sipas Rregullores 01 nr. 360/2803 për dhënien e banesave në shfrytëzim me qira për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

<sup>59</sup> Projekt i financuar nga Emiratet e Bashkuara Arabe.

<sup>60</sup> Këto njësi të banimit social janë siguruar nga transferimi i njësive banesore nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) në komunë për shfrytëzim si banim social, në pajtim me nenin 30 të Ligjit për banim, shënim 12, *sipër*. Në total janë transferuar 35 njësi banimi nga AKP-ja. Për 29 nga këto njësi, banuesve që tashmë ishin të vendosur në ato iu lejua të qëndrojnë meqë u konsiderua se i plotësojnë kriteret për përfitim të banimit social, ndërsa gjashtë njësitë e mbetura u liruan nga njerëzit dhe sendet dhe për ato u bë njoftim publik për pranimin e aplikacioneve.

<sup>61</sup> Nga 18 njësi banimi, tre u janë ndarë familjeve pronat e të cilave janë shpronësuar për ndërtimin e ndërtesës së Prokurorisë Publike, derisa familjet tjera janë përzgjedhur bazuar në vlerësimin e bërë në 2011 për projektin e financuar nga Emiratet e Bashkuara Arabe, shënim 66, *poshtë*.

<sup>62</sup> Zyrtari komunal i intervistuar nuk dha datë të saktë, por theksoi që projekti kishte përfunduar në fund të vitit 2010/fillim të vitit 2011.

<sup>63</sup> Në qershor të vitit 2012, Prizreni (një projekt) dhe Štrpce/Shtërpca (katër projekte) kishin filluar zbatimin e projekteve të banimit, që pritej të përfundonin në fund të 2013-tës. Deri në qershor të vitit 2013 nuk ka pasur asnjë zhvillim. Gračanica/Gračanica (një projekt, dy lokacione) ka përfunduar një projekt banimi social në vitin 2012, përzgjedhja e përfituesve po vazhdon. Në Kamenicë/Kamenica (një projekt), Ferizaj/Uroševac (një projekt) dhe Viti/Vitina (një projekt) projektet e banimit social janë kryer në vitin 2013, përzgjedhja e përfituesve po vazhdon.

## **5.1 Financimi për projektet e banimit social**

Sipas Ligjit për banim, MMPH-ja, komunat dhe donatorët tjerë mund të financojnë projekte të banimit social.<sup>64</sup> Shumica e komunave kanë deklaruar se ato nuk kanë në dispozicion fonde për ndërtimin e banesave sociale dhe mbështeten në donacione. Burimet tjera të financimit përfshijnë institucionet e nivelit qendror<sup>65</sup> dhe burime të tjera të jashtme<sup>66</sup>, ndërsa komuna e Prishtinës/Priştina ka zbatuar një qasje të partneritetit publiko-privat për të ndërtuar dy projekte të saj të banimit.<sup>67</sup> Disa komuna më të mëdha kanë kontribuar nga buxhetet e tyre<sup>68</sup>, ndërsa disa të tjera kanë ndërmarrë hapa të tjerë për t'ua përmirësuar kushtet e banimit familjeve në pozitë të cenueshme, si për shembull duke siguruar materiale ndërtimi apo fonde për përmirësim të banimit.<sup>69</sup>

## **5.2 Shpallja publike e projekteve të banimit social**

Kuadri ligjor i Kosovës përcakton që komuna të bëjë shpallje publike për programet të banimit social nëpër medie dhe në tabelën e shpalljeve të komunës; veç kësaj, shpallja duhet të botohet në gjuhën shqipe dhe atë serbe, si dhe "gjuhët e komuniteteve të tjera sipas nevojës".<sup>70</sup> Sipas zyrtarëve komunalë që janë intervistuar, shumica e komunave që kanë kryer projekte të banimit social i kanë shfrytëzuar mediet lokale dhe tabelat e shpalljeve të komunës dhe i kanë botuar konkurset në të dy gjuhët zyrtare<sup>71</sup>. Megjithatë, ka pasur disa përjashtime që vlen të përmenden. Në Gjakovë/Đakovica dhe Glllogoc/Glogovac, njoftimet janë bërë vetëm në gjuhën shqipe. Ndonëse Glllogoci/Glogovac është komunë e banuar kryesisht nga shqiptarët e Kosovës, kjo nuk

<sup>64</sup> Shih nenin 19, Ligji për banim, shënimi 12 më sipër.

<sup>65</sup> MMPH i ka financuar të dy projektet në Glllogoc/Glogovac (pjesërisht të financuar nga komuna). MPMS ka financuar projekte në: Klinë/Klina, Gjakovë/Đakovica (komuna ka marrë përsipër 50 për qind të kostos), Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica (projekti pritet të përfundojë më vonë gjatë vitit) dhe Gračanica/Gračanicë (dy projekte pritet të përfundohen më vonë gjatë këtij viti). Gjithashtu, MKK po financon pjesërisht projektet me që përfitues do të jenë edhe të kthyerit. Në Štrpce/Shtërpca po ndërtohen katër ndërtesa, prej të cilave katër me financim nga Zyra e Kryeministrit dhe një nga MKK-ja.

<sup>66</sup> Peja/Peć ka fituar fonde nga Emiratet e Bashkuara Arabe në vitin 2011. Në vitin 2011, Agjencia Kosovare e Pronës i ka transferuar komunës së Pejës/Peć disa prona për t'u shfrytëzuar për ndërtim të banesave sociale. Sipas drejtorit të Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në komunën e Suharekës/Suva Reka (intervistë verbale, 3 dhjetor 2012) janë ndërtuar katër shtëpi me fonde të shqiptarëve të Kosovës nga diaspora, gjegjësisht Norvegjia.

<sup>67</sup> Billoqet banesore ndërtohen në tokë komunale nga një kompani ndërtimore private, dhe pastaj disa njësi banesore kalojnë në pronësi të komunës për t'u destinuar për banim social.

<sup>68</sup> Prizren, Gjilan/Gnjilane, Ferizaj/Uroševac, Gjakovë/Đakovica (MPMS e ka mbuluar 50 për qind të kostos), dhe Glllogoc/Glogovac (me financim të pjesshëm nga MMPH).

<sup>69</sup> Komunat në vijim kanë raportuar t'i kenë ndërmarrë këto nisma: Gjilani/Gnjilane, Klina/Klina, Parteshi/Parteshi, Fushë Kosova/Kosovo Polje, Shtimja/Štimlje, Vushtrria/Vučitrn, Podujeva/Podujevo, dhe Mitrovica/Mitrovica. Sipas komunës së Pejës/Peć, çdo vit buxhetor pak ndihmë financiare nga linja e subvencioneve e kryetarit të komunës ndahet për rastet më të rënda sociale që kanë nevojë për ndihmë në banim. Komuna e Vitisë/Vitina ka deklaruar se ka marrë fonde nga MPMS-ja për këtë qëllim.

<sup>70</sup> Shih nenin 4, UA nr. 23/2010, shënimi 15 më sipër.

<sup>71</sup> Shih Figurën 1 në faqen 12 për listën e komunave që kanë përfunduar projekte të banimit social. Prizreni, Kamenica/Kamenica dhe Štrpce/Shtërpca ende nuk kanë bërë ftesa për aplikim, pasi që projektet në këto komuna ende nuk janë përfunduar.



duhet ta lirojë atë nga detyrimi ligjor për t'i botuar konkurse në të dy gjuhët. Në vitin 2012, në Suharekë/Suva Reka<sup>72</sup> dhe Ferizaj/Uroševac<sup>73</sup>, nuk është bërë asnjë thirrje publike për aplikim. Në Suharekë/Suva Reka, komisioni përzgjedhës i ka vizituar të gjitha lagjet e qytetit dhe të gjitha fshatrat për ta kryer vlerësimin. Në Ferizaj/Uroševac<sup>74</sup> ata janë përqendruar vetëm në kërkesat për banesë sociale tashmë të pranuar. Në vitin 2013, thirrjet për aplikim në Ferizaj/Uroševac<sup>75</sup> dhe Viti/Vitina janë bërë në të dy gjuhët zyrtare<sup>76</sup>, në përputhje me kornizën ligjore.

Shqetësime kanë ngritur edhe pjesëtarët e komuniteteve serbishtfolës në komunën e Prishtinës/Priština për dështimin e vazhdueshëm të zyrtarëve komunalë për të bërë njoftime publike në mediet në gjuhën serbe<sup>77</sup>. Meqenëse nuk i përcjellin mediet në gjuhën shqipe, ata janë në padijeni të shpalljeve publike për banim social.

Derisa është për t'u lavdëruar fakti që komunat po marrin nisma për të siguruar banim social, dështimi i disa prej tyre për të bërë shpallje publike në të dy gjuhët zyrtare (apo asnjëfarë shpalljeje), krijon një proces ku mungon transparenca dhe paanshmëria. Në mungesë të thirrjes publike për aplikim në të dy gjuhët zyrtare, jo të gjithë banorët mund të vihen në dijeni për mundësinë e përfitimit të ndihmës për banim. Në veçanti, familjet në pozitë të cenueshme që nuk paraqesin kërkesë për ndihmë për banim me nismën e vet mund të mos identifikohen kurrë nga zyrtarët komunalë si familje në nevojë. Mosrespektimi i kërkesave për përdorim të gjuhëve<sup>78</sup> për njoftim publik mund t'i lë jashtë ata që nuk e flasin gjuhën e shumicës në një komunë të caktuar.

### ***5.3 Themelimi i komisioneve përzgjedhëse***

Kur hartohen programe komunale për banim social, komuna duhet të themelojë një komision përzgjedhës. Ky organ luan një rol qendror meqë është përgjegjës për verifikimin e meritave të aplikimeve individuale për banesë sociale dhe për propozimin e listës përfundimtare të përfituesve. Nga komunat që kishin kryer programe të banimit social që nga nëntori vitit 2010, që të gjitha kishin themeluar komisione formale përzgjedhëse për qëllim të përzgjedhjes së përfituesve.<sup>79</sup> Megjithatë, krahas shpërputhjes mes rregulloreve komunale të komunës së Pejës/Peć, Ferizajt/Uroševac,

---

<sup>72</sup> Drejtari i Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, komuna e Suharekës/Suva Reka, Suharekë/Suva Reka, intervistë verbale, 3 dhjetor 2012.

<sup>73</sup> Drejtari i Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale; Udhëheqësi i Departamentit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, komuna e Ferizajt/Uroševac, Ferizaj/Uroševac, intervistë verbale, 08 maj 2012.

<sup>74</sup> *Po aty*.

<sup>75</sup> Drejtari i administratës së përgjithshme, komuna e Ferizajt/Uroševac, intervistë verbale, 6 shkurt dhe 4 prill 2013.

<sup>76</sup> Drejtari i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, komuna e Vitisë/Vitina, intervistë verbale, 25 prill 2013.

<sup>77</sup> Zyrtari për komunitete dhe kthim dhe zyrtari për informim i komunës së Prishtinës/Priština, Prishtinë/Priština, intervistë verbale, 25 maj 2012.

<sup>78</sup> Shih gjithashtu nenet 7 dhe 8, Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/51, 27 korrik 2006.

<sup>79</sup> Shih Tabelën 1 në faqen 12 për listën e komunave që kanë përfunduar projekte të banimit social. Deri në qershor të vitit 2012, Prizreni, Štrpce/Shtërpca dhe Kamenica/Kamenica ende nuk i kishin themeluar komisionet përzgjedhëse sepse ende nuk i kishin përfunduar së ndërtuari projektet e banimit social.

Prishtinës/Priština dhe Lipjanit dhe kornizës ligjore në këtë çështje (shih Kapitullin 3), kanë lindur edhe shqetësime të tjera.

Siç u përmend më lart, korniza ligjore nuk flet për formën që duhet ta kenë komisionet përzgjedhëse<sup>80</sup>, megjithatë, praktika më e mirë është që ato të mbeten jopolitike, t'i pasqyrojnë në përbërjen e tyre komunitetet që jetojnë në komunë dhe të përfshijnë persona të trajnuar në trajtimin e grupeve në pozitë të cënueshme. Duke e pasur parasysh të gjithë këtë, përbërja e disa prej këtyre komisioneve përzgjedhëse në praktikë ngre disa shqetësime. Komisionet përzgjedhëse të krijuara në Pejë/Peć<sup>81</sup>, Ferizaj/Uroševac<sup>82</sup>, Gjakovë/Đakovica<sup>83</sup>, Klinë/Klina<sup>84</sup> dhe Glllogoc/Glogovac<sup>85</sup> janë tepër të dominuara nga anëtarë të kuvendeve komunale. Favorizimi i përfaqësuesve të partive politike mund të çojë në politizim të procesit të përzgjedhjes, sidomos në kuptim të mundësisë së përzgjedhjes së përfituesve të cilët kanë lidhje politike me ato parti.

Shqetësim të dukshëm përbën fakti se rreth gjysma e komisioneve përzgjedhëse kanë qenë të përbëra vetëm nga shqiptarë të Kosovës, duke dështuar kështu që t'i pasqyrojnë në përbërjet e tyre komunitetet e tjera që jetojnë në komunë. Kështu ka ndodhur në Prishtinë/Priština (të dy komisionet përzgjedhëse)<sup>86</sup>, Ferizaj/Uroševac (për projektin e 2013-ës), Glllogoc/Glogovac, Klinë/Klina dhe Suharekë/Suva Reka.<sup>87</sup> Donatorët e

<sup>80</sup> Siç është përmendur tashmë në Kapitullin 3 të këtij raporti, kuadri ligjor përcakton vetëm që komisioni përzgjedhës duhet të përbëhet nga tre deri pesë anëtarë të cilët duhet të zgjidhen nga kryetari i komunës.

<sup>81</sup> Siç u përmend më herët, rregullorja komunale e komunës së Pejës/Peć përcakton që komisioni përzgjedhës të ketë në përbërjen e tij nëntë anëtarë, shtatë nga të cilët janë anëtarë të kuvendit komunal, ndërkaq dy të tjerët janë përfaqësues të QPS-së dhe Shoqatës së Veteranëve të Luftës. Megjithatë, siç është raportuar, në vend të përfaqësuesve të QPS-së, anëtar i komisionit është emëruar zyrtari ligjor nga Drejtoria për shëndetësi e komunës. Burimi: Drejtori i Drejtorisë komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, 12 shkurt 2012.

<sup>82</sup> Neni 15.2 i rregullores komunale të komunës së Ferizajt/Uroševac, shënim 22, sipër, përcakton që komisioni përzgjedhës të ketë në përbërjen e tij njëmbëdhjetë anëtarë, pesë nga të cilët anëtarë të kuvendit komunal, një nga drejtoria komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, një nga Shoqata e Veteranëve të Luftës, një nga Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve, një nga Shoqata e ish të Burgosurve Politik dhe një nga Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara, burim: Drejtori i Drejtorisë komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, 13 dhjetor 2012.

<sup>83</sup> Në Gjakovë/Đakovica, komisioni përzgjedhës përbëhet nga shtatë anëtarë, që të gjithë anëtarë të kuvendit komunal. Burimi: Drejtori i Drejtorisë komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, 6 qershor 2012.

<sup>84</sup> Në Klinë/Klina, komisioni përzgjedhës përbëhet nga katër anëtarë të kuvendit komunal dhe drejtori i Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Burimi: Drejtori i Drejtorisë komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, 4 qershor 2012.

<sup>85</sup> Në Glllogoc/Glogovac, komisioni përzgjedhës përbëhet nga tre anëtarë të kuvendit komunal dhe dy punonjës të komunës (nuk është deklaruar se çfarë pozita mbajnë ata). Drejtori i Drejtorisë komunale për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, 20 maj 2013.

<sup>86</sup> Në Prishtinë/Priština, njëri komision përzgjedhës është themeluar sipas Rregullores komunale të Prishtinës/Priština Nr. 360/1938, shënimi 21, më sipër. Ky komision përbëhet nga pesë anëtarë të cilët vijnë nga drejtoria e administratës dhe ajo e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, dhe QPS. Një tjetër komision përzgjedhës është themeluar sipas Rregullores komunale të Prishtinës/Priština Nr. 360/2803, shënimi 21 më sipër. Ky komision përbëhet nga dy nëpunës civilë nga Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, një anëtar i kuvendit komunal dhe dy përfaqësues të Shoqatës së Veteranëve të Luftës.

<sup>87</sup> Komisioni përzgjedhës në Suharekë/Suva Reka në përbërjen e tij kishte katër drejtorë komunalë nga drejtoritë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale; planifikimit, zhvillimit dhe bujqësisë; administratës së përgjithshme; dhe planifikimit hapësinor dhe urbanizmit (drejtori i Drejtorisë për shëndetësi dhe

projektit të banimit në komunën e Suharekës/Suva Reka (shqiptarë të Kosovës nga diaspora) kanë kërkuar shprehimisht që nga projekti të përfitojnë vetëm shqiptarët e Kosovës<sup>88</sup>. Po ashtu, është shqetësuese që të dy komisionet përzgjedhëse të themeluara në Gračanica/Gračanicë<sup>89</sup> (komunë me shumicë serbe) përbëhen vetëm nga serbët e Kosovës. Megjithatë, disa komuna të tjera kanë siguruar përfaqësimin e komuniteteve në pakicë numerike në komisionet përzgjedhëse të tyre, p.sh. komisionet në Pejë/Peć, Gjakovë/Đakovica, Gjilan/Gnjilane<sup>90</sup>, Viti/Vitina<sup>91</sup> dhe Ferizaj/Uroševac (për projektin e 2010/2011)<sup>92</sup> kanë pasur nga një përfaqësues të tillë. Mospërfaqësimi i komuniteteve që janë pakicë numerike në shumë komisione përzgjedhëse të tjera përbën shqetësim mjaft të madh, meqë pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje është e rëndësishme për të siguruar njohjen dhe adresimin e nevojave të komunitetit të tyre.

Veç kësaj, siç u përmend më herët, komisionet përzgjedhëse në Pejë/Peć, Kamenicë/Kamenica<sup>93</sup>, Ferizaj/Uroševac<sup>94</sup>, Lipjan/Lipjane<sup>95</sup> dhe Prishtinë/Priština (në veçanti Rregullorja e dytë 01 nr. 360/2803 për dhënien e banesave në shfrytëzim me qira për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës) në përbërjen e tyre kanë edhe përfaqësues të Shoqatës së Veteranëve të Luftës. Përbërja e këtillë mund shkojë në favor të atyre që kanë marrë pjesë në konflikt në vend se të atyre të cilët janë në pozitë më të cenueshme.

Rreziku i politizimit të mundshëm të komisionit përzgjedhës - nëpërmjet dominimit të tij nga anëtarë të kuvendit komunal, mungesa e përfaqësimit të komuniteteve dhe favorizimi i shoqatave të veteranëve të luftës - ngre shqetësime serioze rreth paanshmërisë dhe

---

mirëqenie sociale i komunës së Suharekës/Suva Reka, Suharekë/Suva Reka, intervistë verbale, 3 dhjetor 2012).

<sup>88</sup> *Po aty*.

<sup>89</sup> Në Gračanica/Gračanicë po realizohen dy projekte banimi dhe ato do të destinohen për të kthyerit dhe personat e zhvendosur, si dhe persona të tjerë në pozitë të cenueshme. Projektet po financohen pjesërisht nga MPMS-ja dhe MKK-ja. Rrjedhimisht, janë themeluar dy komisione përzgjedhëse. I pari do të vlerësojë aplikimet e të kthyerve dhe personave të zhvendosur, dhe përbëhet nga një përfaqësues i UNHCR-it, një i MKK-së dhe një i komunës. I dyti do të vlerësojë aplikimet e personave të tjerë në nevojë të ndihmës në banim dhe përbëhet nga një përfaqësues i QPS-së, një i MPMS-së dhe një i komunës.

<sup>90</sup> Komisioni përzgjedhës në Gjilan/Gnjilane kishte në përbërjen e tij pesë anëtarë, katër nga të cilët ishin shqiptarë të Kosovës (një nëpunës civil nga Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, sekretari i kuvendit komunal, dhe dy të tjerë rreth të cilëve nuk janë dhënë hollësi) dhe një serb i Kosovës (ish-zyrtar komunal për kthim).

<sup>91</sup> Në Viti/Vitina, komisioni përzgjedhës përbëhej nga pesë anëtarë, katër nga të cilët ishin shqiptarë të Kosovës (një përfaqësues nga organizatat joqeveritare, një nga shoqatat e veteranëve të luftës, një nëpunës civil nga Drejtoria për ekonomi, buxhet dhe financa, një nga QPS-ja) dhe një serb i Kosovës nga MKK-ja. Drejtori i drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, intervistë verbale, 25 prill 2013.

<sup>92</sup> Drejtori i Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale; Udhëheqësi i Departamentit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, komuna e Ferizajt/Uroševac, Ferizaj/Uroševac, intervistë verbale, 08 maj 2012.

<sup>93</sup> Neni 10 i Rregullores komunale të Kamenicës/Kamenica përcakton që komisioni përzgjedhës të ketë në përbërjen e tij pesë anëtarë (një përfaqësues i shoqatave të veteranëve të luftës dhe katër kuvendit komunal), shih shënimin 23 më sipër.

<sup>94</sup> Në Ferizaj/Uroševac, nga të njëmbëdhjetë anëtarët e komisionit përzgjedhës, tre përfaqësues janë nga Shoqata e Veteranëve të Luftës, një nga Shoqata e Dëshmorëve të Luftës, një nga Shoqata e Invalidëve të Luftës dhe një nga Shoqata e ish të Burgosurve Politik. Drejtori i administratës së përgjithshme, intervistë verbale, 06 shkurt 2013.

<sup>95</sup> Shih nenin 10 të Rregullores së komunës së Lipjanit/Lipljane, shënimin 20 më sipër.

marrjes parasysh të nevojave gjatë procesit të përzgjedhjes së përfituesve. Prandaj, është e rekomandueshme që në përbërjen e këtyre komisioneve të përfshihen përfaqësues nga qendrat për punë sociale (QPS) dhe drejtoritë komunale për mirëqenie sociale, meqë personeli i tyre është zakonisht i trajnuar në vlerësimin dhe trajtimin e personave në pozitë të cenueshme që kanë nevojë për ndihmë sociale, sidomos kur merret parasysh se QPS-të janë përgjegjëse për administrimin e skemës së ndihmës sociale. Vetëm komunat e Pejës/Peć, Klinës/Klina, Prishtinës/Priština, Lipjanit/Lipljane, Suharekës/Suva Reka, Gjilanit/Gnjilane<sup>96</sup> dhe Graçanicës/Gračanica kanë përfshirë së paku një anëtar të tillë në përbërjen e gjithsecilit komision të tyre.<sup>97</sup> Sidoqoftë, komunat duhet të përpiqen që në përbërjen e komisioneve përzgjedhëse të përfshijnë përfaqësues të komuniteteve, që janë minoritetet numerik për të siguruar njohjen dhe mbrojtjen e nevojave të komuniteteve të tyre.

#### ***5.4 Përzgjedhja e përfituesve***

Komisionet komunale për përzgjedhje janë përgjegjëse për shqyrtimin e aplikimeve për banesë sociale, duke vendosur në bazë të meritave që i kanë<sup>98</sup>, dhe për propozimin e listës përfundimtare të përfituesve për çdo projekt të banimit social. Përkitazi me projektet e banimit social që janë kryer gjatë periudhës së raportimit, të gjitha komunat kanë deklaruar se komisionet përzgjedhëse i kanë vlerësuar aplikimet sipas meritave të tyre, pas vizitave nëpër shtëpi për të vlerësuar gjendjen e atyre që kanë aplikuar. Përfaqësuesit e komuniteteve e kanë konfirmuar këtë në të gjitha rastet, me përjashtim të rastit të Klinës/Klina<sup>99</sup>, ku përfaqësuesi i komunitetit ka deklaruar se komuna nuk ka bërë vizita nëpër shtëpitë e anëtarëve të komunitetit që kishin aplikuar për banesë sociale.

Përgjithësisht, ka mungesë të informacioneve gjithëpërfshirëse rreth procesit të aplikimit (për shembull, numri total i aplikimeve dhe zberthimi i këtyre të dhënave në kategori). Kjo padyshim lidhet me mungesën e përgjithshme të të dhënave gjithëpërfshirëse komunale rreth banimit, të shtjelluara më lart. Me përjashtim të Gjilanit/Gnjilane, zyrtarët komunalë kanë deklaruar se nuk mund të sigurojnë të dhëna të zberthyera në kategori për personat që kanë aplikuar për banesë sociale. Por, shumica e komunave mundën të sigurojnë të dhëna të kategorizuara (ndonëse vetëm sipas përkatësisë etnike) për personat të cilëve në fund u është dhënë banesë sociale. Këto shifra janë konfirmuar përgjithësisht nga përfaqësuesit e komuniteteve, me përjashtim të rasteve kur përfaqësuesit e komuniteteve nuk kanë qenë fare në dijeni se janë dhënë banesa sociale. Në mënyrë interesante, komuna e Ferizajit/Uroševac nuk mundi të jepte asnjë të dhënë, ndonëse po i njëjti zyrtar i intervistuar iu referua një "liste aplikuesish" nga e cila përzgjidheshin

---

<sup>96</sup> Drejtori i Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale; udhëheqësi i Zyrës për komunitete dhe kthim, komuna e Gjilanit/Gnjilane, Gjilan/Gnjilane, intervistë verbale, 16 maj 2012.

<sup>97</sup> Shih shënimet 81-90 më sipër.

<sup>98</sup> Ligji për banim krijon një sistem pikësh sipas të cilit përfituesit e mundshëm fitojnë pikë në disa kategori: statusi i banimit, lartësia e të ardhurave, gjendja shëndetësore, invaliditeti, struktura e familjes dhe kritere të tjera shtesë (familje e dëshmorit, familje me një prind, familje që kujdeset për jetimë). Shih nenin 5 të Ligjit për banim, shënimi 12 më sipër. Shih gjithashtu nenet 5-10 dhe Shtojcën 1 të U.A. 21/2010, shënimi 15 më sipër.

<sup>99</sup> Kryesuesi i Komitetit të komunitete, komuna e Klinës/Klina, Klinë/Klina, intervista verbale, 4 qershor 2012 dhe 31 maj 2013.

përfituesit<sup>100</sup>. Tabela 2 tregon numrin e banesave sociale që janë ndarë, ashtu siç është raportuar nga komunat, të kategorizuara sipas përkatësisë etnike të përfituesve.

Projekte për komunë	Viti	Nr. i njësive	Nr. i njësive që u janë ndarë komunitetit shqiptar të Kosovës	Nr. i njësive që u janë ndarë komunitetit joshqiptar
Pejë/Peć (1)	2011	25	24	1
Pejë/Peć (2)	2011	6	5	1
Pejë/Peć (3)	2013	18	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna
Gjakovë/Đakovica	2011	25	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna
Klinë/Klina	2011	25	24	1
Gjilan/Gnjilane (1)	2010	9	9	0
Gjilan/Gnjilane (2)	2011	27	25	2
Ferizaj/Uroševac (1)	2010/11	13	s'ka	s'ka
Ferizaj/Uroševac (2)	2011	4	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna
Suharekë/Suva Reka (1)	2011	4	4	0
Prishtinë/Priština (1)	2011	48	47	1
Prishtinë/Priština (2)	2012	52	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna
Glllogoc/Glogovac (1)	2010	25	25	0
Glllogoc/Glogovac (2)	2011	23	23	0

**Tabela 2: Njësitë e banimit social që janë ndarë, sipas komunave**

Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave gjithëpërfshirëse rreth banimit social (siç janë numri i njerëzve të cilët kanë vërtetë nevojë për banesë sociale, numri i njerëzve të cilët aplikojnë për banesë sociale dhe kategorizimi i këtyre të dhënave) është e vështirë të vlerësohet paanshmëria e ndarjes përfundimtare të njësive të banimit social. Megjithatë, nga Tabela 2 shihet se shumica e njësive banesore u janë ndarë pjesëtarëve të komuniteteve në shumicë numerike në komunat përkatëse, e që përbën shqetësim serioz. Çështjet sikurse mosnjohimi publik për projekte banimi, mosrespektimi i kërkesave për përdorim të gjuhëve për njoftim publik (shih Kapitullin 5.2 më sipër) dhe themelimi i komisioneve përzgjedhëse të përbëra vetëm nga anëtarët e komunitetit në shumicë numerike (shih Kapitullin 5.3 më sipër) mund të kenë kontribuar në këtë. Siç u shtjellua më herët, në Suharekë/Suva Reka ka pasur qartazi një politikë diskriminuese për të përzgjedhur si përfitues vetëm shqiptarët e Kosovës, gjë që, ashtu siç raportohet, është

<sup>100</sup> Udhëheqësi i njësive për ndihmë sociale i komunës së Ferizajt/Uroševac, Ferizaj/Uroševac, intervistë verbale, 8 maj 2012.

bërë me kërkesë të donatorëve (shqiptarë të Kosovës nga diaspora)<sup>101</sup>. Duhet vënë në dukje që, në Viti/Vitina kryetari i komunës ka vendosur në mënyrë arbitrare që nga gjithsej 25 banesat në kuadër të projektit për të cilin po bëhet përzgjedhja e përfituesve, katër t'u ndahen veteranëve të luftës, njëzet rasteve sociale dhe një komuniteteve joshqiptare.<sup>102</sup>

T'u dalësh në ndihmë komuniteteve që janë në pozitën më të cenueshme dhe kanë nevojë për strehim, siç janë, për shembull, ato që banojnë në vendbanime joformale, është pjesë thelbësore e përgjegjësisë për të siguruar të drejtën për banim adekuat. Në Kosovë, detyrimi për të kryer vlerësim gjithëpërfshirës të nevojave për banim dhe për të krijuar baza të të dhënave për përcjelljen e ndihmave në banim social u takon komunave, për të siguruar që ndarja e banesave sociale të bëhet në mënyrë gjithëpërfshirëse, transparente dhe të paanshme. Ky monitorim dhe mbledhje e të dhënave janë thelbësorë për t'i identifikuar komunitetet në pozitë veçanërisht të marginalizuar apo të pafavorshme dhe për ta mundësuar, më pas, synimin e projekteve për përmirësimin e statusit të tyre të banimit. Por, pothuajse asnjë komunë nuk ka bërë përpjekje të veçanta për t'ju dalë në ndihmë komuniteteve në pozitë veçanërisht të cenueshme që jetojnë në zonat e tyre. Disa komuna kanë pohuar ta kenë bërë këtë, ndonëse ato nuk mund ta mbështetnin pohimin me çfarëdo hollësie specifike dhe asnjë përfaqësues i komunitetit nuk i ka konfirmuar këto pohime.

### **5.5 Mekanizmi ankimor**

Korniza ligjore parasheh që palët e pakënaqura kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në MMPH kundër vendimeve përfundimtare që i nxjerrë komisioni komunal për përzgjedhje.<sup>103</sup> Në shkallë të dytë, ankesat mund të parashtrohen në Gjykatë Supreme.<sup>104</sup> Sipas zyrtarëve komunalë, ankesa janë parashtruar vetëm në Pejë/Pec, Prishtinë/Priština dhe Gjiilan/Gnjilane. Mirëpo, procedura e rregullt e ankimit nuk shfrytëzohet dhe ankesat i parashtrohen drejtpërdrejt komisionit komunal për përzgjedhje.

Për shembull, kështu ka ndodhur në Pejë/Pec dhe Prishtinë/Priština. Në Pejë/Pec, në shkallë të dytë, ankesat i janë dërguar Gjykatës Supreme.<sup>105</sup> Në Prishtinë/Priština, komisioni komunal përzgjedhës ka pranuar më se 150 ankesa kundër projektit të parë të banimit të 2011-tës, dhe 125 ankesa kundër listës preliminare të përfituesve të projektit të dytë. Sipas komunës së Prishtinës/Priština, ata i kanë regjistruar ankesat dhe më pas ua kanë përcjellë ato MMPH-së. Por, përfaqësuesit e MMPH-së deklarojnë të mos kenë

---

<sup>101</sup> Shih shënimet 87 dhe 88 sipër. Gjithashtu, sipas drejtorit të Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale të komunës së Suharekës/Suva Reka (intervistë verbale, 3 dhjetor 2012), janë ndërtuar katër shtëpi me financim nga shqiptarë të Kosovës nga diaspora me banim në Norvegji.

<sup>102</sup> Vendim i kryetarit të komunës, i datës 22 mars 2013.

<sup>103</sup> Neni 14(1) i Ligjit për banim, shënimi 12 më sipër.

<sup>104</sup> Neni 14(3) i Ligjit për banim, shënimi 12 më sipër. Shih gjithashtu nenet 5.7 dhe 6.2 të U.A. 22/2010, shënimi 15 më sipër.

<sup>105</sup> Shih rregulloren komunale të Pejës/Pec, shënim 19, më sipër. Ankesat e paraqitura në Pejë/Pec kanë të bëjnë me gjashtë banesa që AKP-ja ia ka kaluar në menaxhim komunës.

pranuar asnjë ankesë. Rrjedhimisht, duket që këto ankesa nuk i dërgohen MMPH-së por shqyrtohen vetëm nga komisionet përzgjedhëse në nivel të komunës<sup>106</sup>.

Sipas komunës së Gjilanit/Gnjilane, si ankesat verbale ashtu edhe ato me shkrim u janë drejtuar direkt kryetarit të komunës, Departamentit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale apo anëtarëve të komisionit përzgjedhës.

Në rastin e Prishtinës/Priština dhe Pejës/Peć, dështimi për ta shfrytëzuar procedurën e rregullt të ankimit është me gjasë i lidhur me mekanizmin ankimor të përcaktuar nëpër rregulloret komunale. Në të dyja rastet, siç u shtjellua më herët, rregulloret lejojnë që ankesat t'i parashtrohen komisionit përzgjedhës dhe më pas Gjykatës Supreme, pa asnjë dispozitë që përcakton ushtrimin e ankesës në MMPH.

Dështimi i komunave të Prishtinës/Priština, Pejës/Peć dhe Gjilanit/Gnjilane për ta respektuar procedurën e rregullt të ankimit dhe për t'i informuar palët gjegjëse të pakënaqura mund të çojë në shkeljen e së drejtës së këtyre palëve për mjete juridike efektive, si dhe së drejtës së tyre në banim adekuat.

## 6. PËRFUNDIM

MMPH ka ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm në drejtim të realizimit të së drejtës në banim adekuat duke miratuar kornizën ligjore aktuale, duke marrë masa për ta promovuar këtë kornizë në nivel komunal, si dhe duke themeluar një komision të përbashkët me MAPL-në për ta shqyrtuar ligjshmërinë e rregulloreve komunale. Disa komuna kanë miratuar masa që synojnë realizimin e kësaj të drejte përmes zbatimit të projekteve të banimit social, duke iu siguruar kështu drejtpërdrejt banim personave në nevojë. Deri në gusht të vitit 2013, tetë komuna kishin zbatuar 14 projekte që rezultuan në ndarjen e 304 njësisve banesore familjeve dhe personave në nevojë të ndihmës në banim. Komunat tjera kanë nisur po ashtu projekte banimi, shpesh me financim të plotë ose të pjesshëm nga MMPH-ja, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim.

Megjithatë, korniza ligjore në nivel komunal vazhdon të ngre shqetësime të shumta. Në secilën prej komunave që kanë miratuar rregulloret për banim social, ka probleme të shpërputhjes në mes të aspekteve të rëndësishme të këtyre rregulloreve dhe kornizës ligjore. Fushat e shpeshta të shpërputhjes lidhen me kriteret për përzgjedhjen e përfituesve, përbërjen e komisioneve komunale për përzgjedhje, si dhe procedurën e ankimit. Dështimi i disa komunave për ta respektuar kornizën ligjore ngre pyetje serioze përkitazi me ligjshmërinë dhe paanshmërinë e projekteve të banimit social të zbatuara në to. Për më tepër, mosrespektimi i procedurës së rregullt të ankimit ndërhyt në të drejtën për mjete juridike efektive. Komisionit i përbashkët i themeluar rishtazi nga MMPH-ja dhe MAPL-ja për të shqyrtuar ligjshmërinë e rregulloreve komunale përbën zhvillim

---

<sup>106</sup> Kryesuesi i komisionit përzgjedhës të Prishtinës/Priština, Prishtinë/Priština, intervistë verbale, 2 korrik 2012.

pozitiv që ka potencial për t'i adresuar këto shqetësime në mënyrë kuptimplote. Disa komuna të tjera vazhdojnë të punojnë me Udhëzimet e vjetruara të MMPH-së për banim social, që datojnë nga viti 2007.

Vlen gjithashtu të përmendet se vetëm komuna e Pejës/Peç ka kryer vlerësimin e nevojave për banim, ndërkohë që asnjë komunë nuk ka hartuar asnjëfarë strategjie të banimit deri më sot.<sup>107</sup> Si rrjedhim, kjo mungesë informatash ia ka vështirësuar MMPH-së përbushjen e përgjegjësiave të saj për të hartuar një strategji trevjeçare për tërë Kosovën dhe për të krijuar bazë të këtyre të dhënave. Siç e vë në dukje KDESK, monitorimi adekuat i gjendjes, përfshirë përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave të kategorizuara, është qenësor për ta përcaktuar shkallën dhe natyrën e problemit të banimit joadekuat dhe për të mundësuar identifikimin e grupeve sociale në pozitë veçanërisht të cenueshme ose të pafavorshme që kanë nevojë për ndihmë. Gjithashtu, hartimi i një strategjie të banimit është hap i rëndësishëm drejt planifikimit të reagimeve të përshtatshme ndaj nevojave për banim që identifikohen.

Zbatimi i projekteve të banimit social është mënyrë thelbësore dhe e rëndësishme në të cilën institucionet qeveritare mund të punojnë konkretisht në drejtim të realizimit të së drejtës për banim adekuat. Megjithatë, janë identifikuar disa shqetësime dhe mangësi procedurale. Ndonëse komunat e kanë për detyrë që të bëjnë shpallje publike të projekteve të banimit social, disa kanë dështuar që ta bëjnë këtë krejtësisht ose kanë dështuar që ta bëjnë në të dyja gjuhët zyrtare. Si rezultat, disa individë ose komunitete që janë pakicë gjuhësore kurrë nuk vihen në dijeni të mundësisë së aplikimit për banesë sociale.

Megjithëse korniza ligjore nuk e shtjellon përbërjen e komisioneve komunale për përzgjedhje, ka mangësi të qarta sa i përket përbërjes së tyre në disa komuna që mund ta minojnë objektin dhe qëllimin e banimit social: t'ju ndihmohet atyre që kanë më së shumti nevojë. Përbërja e disa komisioneve përzgjedhëse është tepër apo tërësisht e dominuar nga anëtarë të kuvendit komunal, e që ka mundësi të çojë në politizim të procedurës së përzgjedhjes. Disa komisione përzgjedhëse janë njëetnike, gjë që është në shpërputhje me praktikën më të mirë të sigurimit të përfshirjes dhe pjesëmarrjes së komuniteteve në pakicë numerike, për të siguruar që të drejtat e komuniteteve të tyre gjithashtu të njihen dhe të respektohen. Gjithashtu, disa komuna parashohin përfshirjen e anëtarëve të Shoqatës së Veteranëve të Luftës në komisionet përzgjedhëse që mund të shkojë në dobi të atyre që kanë marrë pjesë në konflikt, në vend se personave të cilët kanë thjesht më së shumti nevojë për ndihmë në banim. Përfshirja e anëtarëve të shoqatave të veteranëve të luftës në komisionet përzgjedhëse mund të shihet si legjitime, nëse prania e tyre nuk do t'i favorizonte veteranët e luftës mbi baza të tjera përveç nevojës sociale, dhe me kushtin që në komisione përzgjedhëse të përfshihen edhe përfaqësues të përfituesve të tjerë të mundshëm (p.sh. personat me aftësi të kufizuara dhe grupe të tjera në pozitë të cenueshme). Disa komuna nuk përfshijnë në përbërjen e komisioneve të tyre përzgjedhëse zyrtarë nga drejtoritë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale apo QPS-të. Do të ishte e këshillueshme që të gjitha komunat ta ndjekin këtë praktikë, meqë këto organe komunale kanë të punësuar individë të trajnuar dhe me përvojë në çështje të mirëqenies

---

<sup>107</sup> *Po aty.*



sociale, të cilët për rrjedhim janë më të përgatitur për t'i identifikuar dhe vlerësuar ata që janë më së shumti në nevojë.

Përveç të dhënave joadekuata për shkak të mungesës së vlerësimeve komunale të nevojave për banim, ka edhe mungesë të përgjithshme të të dhënave të kategorizuara sipas numrit të aplikuesve për banim social, si dhe numrit të përfituesve të banesave sociale. Të dhëna të tilla gjithëpërfshirëse janë të domosdoshme për të mundësuar monitorimin e duhur të procedurës së përzgjedhjes dhe përparimit të bërë në rrugën drejt realizimit të së drejtës për banim adekuat për të gjithë. Në mënyrë të veçantë, në përputhje me detyrimin e qeverisë për ta realizuar në mënyrë progresive të drejtën për banim adekuat, përcjellja e këtyre informacioneve është thelbësore për të siguruar administrimin e projekteve të banimit në mënyrë jodiskriminuese, ashtu që të identifikohen dhe të përfitojnë çfarëdo grupe sociale në pozitë veçanërisht të pafavorshme apo të marginalizuar.

Komunat kanë dështuar gjithashtu që ta respektojnë procedurën e ankimit të përcaktuar në Ligjin për banim. Në rastet kur janë ushtruar ankesa kundër përzgjedhjes së përfituesve, këto të fundit i kanë shkuar po të njëjtit komision komunal për përzgjedhje që e ka bërë procedurën e përzgjedhjes, dhe jo MMPH-së, ashtu siç kërkohet sipas Ligjit për banim. Mosrespektimi i procedurës së rregullt të ankimit dhe mosinformimi i palëve të pakënaqura mund të çojë në shkelje të së drejtës për mjet juridik efektiv, si dhe të drejtës në banim adekuat.

## **7. REKOMANDIME**

### **Për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor:**

- Të angazhohet sërish në aktivitete siç janë punëtoritë, për t'i udhëzuar komunat përkitazi me kornizën ligjore, kryerjen e vlerësimeve të nevojave për banimin dhe hartimin e strategjive për banim.
- Të hartojë menjëherë një strategji trevjeçare për tërë Kosovën dhe të krijojë një bazë të të dhënave për banimin, në pajtim me nenin 24.1 të Ligjit për banim.
- Të shqyrtojë rregullisht dhe me kohë ligjshmërinë e të gjitha rregulloreve komunale, duke përfshirë edhe ato për banim social.

### **Për komunat:**

- Të sigurojnë që personeli i cili merret me projekte të banimit social të jetë në dijeni dhe t'ju përmbahet dispozitave të kornizës aktuale ligjor për banim social.
- Të sigurojnë që rregulloret komunale të jenë në përputhje me kornizën ligjore dhe t'ua dorëzojnë ato për shqyrtim autoritetit përgjegjës në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në pajtim me nenin 27 të Ligjit për banim dhe nenet 80 dhe 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale.
- Të bëjnë vlerësime gjithëpërfshirëse të nevojave për banim në mbarë komunën, në të cilat duhet të mblidhen të dhëna të ndara sipas kategorive në mënyrë që të identifikohen çfarëdo grupe sociale në pozitë veçanërisht të cënueshme apo të marginalizuar, në pajtim me nenin 25.1.1 të Ligjit për banim.

- Të hartojnë strategji trevjeçare komunale për banim në bazë të këtyre vlerësimeve të nevojave, në pajtim me nenin 25.1.2 të Ligjit për banim.
- Të sigurojnë që nevojat dhe të drejtat e komuniteteve në pakicë numerike të njihen dhe të respektohen nëpërmjet përfshirjes së përfaqësuesve të tyre në komisionet përzgjedhëse komunale.
- Të përfshijnë në përbërjen e komisioneve përzgjedhëse punonjës përkatës nga Drejtoritë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale apo QPS-të, të cilët janë të trajnuar në identifikimin dhe trajtimin e personave në nevojë për ndihmë sociale.
- Të monitorojnë në mënyrë të duhur zbatimin e projekteve të banimit social duke i përcjellë të dhënat e kategorizuara sipas numrit të aplikuesve dhe përfituesve, për të siguruar që projektet të zbatohen në mënyrë të paanshme dhe jodiskriminuese, dhe të synojnë çfarëdo grupesh sociale në pozitë veçanërisht të cënueshme ose të marginalizuar.
- T'i përmbahen procedurës së ankimit të paraparë me ligj për të siguruar respektimin e së drejtës në banim adekuat të të gjithë personave, si dhe të drejtën e tyre për mjet juridik efektiv kur atyre u mohohet padrejtësisht banimi social.

**Për bashkësinë ndërkombëtare:**

- T'i ndihmojë institucionet e Kosovës për të realizuar të drejtën e personave dhe familjeve në nevojë në banim adekuat, mes tjerash, duke siguruar financimin shumë të nevojshëm për projekte të banimit social.
- Ta kushtëzojë financimin për projekte të banimit social me zbatim në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut.